



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - HANI I ELEZIT
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE



02/ 2779 2023

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr. 06/L-114, Ligjit , nenit 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125 nenit 69 pika 1.1. Udhëzimin Administrativ(MSH) Nr.02/2015 Organizimi, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësorë neni 14 pika 1.1 . Udhëzimit Administrativë nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kryetari i Komunës në Hani i Elezit Shpall këtë:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Një Mjekë-e të Mjekësisë Familjare
Institucioni: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi” - Hani i Elezit
Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave: Një (1)
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i QKMF-së
Grada/Koeficienti: Koeficienti H 10-7.4
Kohëzgjatja e Kontratës: (Pa afat)
Orët e punës: 40

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ndihmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëminë të cilën është trajnuar.
2. Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë, kartelën e pacientit si dhe dokumente të tjera.
3. Jep udhëzime me gojë dhe me shkrim për trajtime të pacientit.
4. Merr pjesë në hartimin e planit dhe programit në vendin e punës ku punon.
5. Mban kujdestarinë e radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.
6. Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i aplikon masat tjera shëruese.
7. Ndihmon në preventivin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët në lidhje me dietën ushtrimet, higjienën dhe shëndetin në përgjithësi.
8. Të raportojë për lindjet, vdekjet, sëmundjet ngjitëse autoriteteve kompetente.
9. Të referojë pacientët tek specialistët mjekësorë dhe të shkëmben me ta të dhënat mjekësore.
10. Të përpilojë raporte me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tij.
11. Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin e lartë në punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave të punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Letërnjoftimi kopje.
- Dëshminë për shkollimin e mbaruar Diploma (e vërtetuar).
- Licenca (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore.
- Certifikatën që nuk është nën Hetime (nga Gjykata).
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka).
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Periudha e kontratës: 6 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi në bazë të rezultateve në punë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **27.04.2023** deri **11.05.2023 (16:00)**.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatet nga lista e ngushtë.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në tabelën e shpalljes.

